



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 78, DATË 03.09.2020

PËR

ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË SHOQËRISË
“ALBANIAN FIBER SYSTEMS” SH.P.K., AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E
SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË
RRJET KABLLOR “TV KABLLOR AFS”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1/b, nenit 55, pika 4/b të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 2028 prot., datë 23.07.2020, të shoqërisë “Albanian Fiber Systems” sh.p.k., Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Albanian Fiber Systems” sh.p.k., me administrator: z. Dritan Shameti dhe NIPT: K 91808001 B, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor AFS”, në njësinë administrative Korçë.
2. Zona e ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Albanian Fiber Systems” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor AFS”, ndryshon në njësitë administrative Qendër Bulgarec, Drenovë, Pojan, Udenisht dhe Buçimas, Shalës, Pogradec dhe Korçë.
3. Kushtet e autorizimit të subjektit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor AFS”, mbeten të pandryshuara, përveç zonës së ofrimit të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA